



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:036098

Datë: 03.05.2024

Numri i dokumentit: 05653292

C.nr.541/23

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Agron Karatash, me bashkëpunëtorin profesional A.K. në çështjen juridike kontestimore të inicuar me padi nga ana e paditësve L.Sh., I.R., Xh.H., M.E., A.B. që të gjithë punonjës në Gjimnazin “Gjon Buzuku” në Prizren, të cilët me autorizim i përfaqëson av. V.H. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e ushqimit gjatë ditëve të pranisë në punë, me vlerë të kontestit 1,484.00 euro, me datë .05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpapia e paditëses A.B.

II. APROVOHET në tërësi kërkesëpapia e paditësve L.Sh., I.R., Xh.H., M.E., **si e bazuar.**

III. DETYROHET e paditura, Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, që paditësve:

- **Paditësit të parë L.Sh.** në emër të kompensimit për ushqim gjatë ditëve të pranisë në punë, për periudhën kohore prej datës 01.01.2022 e deri më datën 20.11.2022 për 162 ditë pune t’ia kompensoj shumën prej **324.00 euro.**

- **Paditësit të dytë I.R.** në emër të kompensimit për ushqim gjatë ditëve të pranisë në punë, për periudhën kohore prej datës 01.01.2022 e deri më datën 20.11.2022 për 161 ditë pune t’ia kompensoj shumën prej **322.00 euro.**

- **Paditësit të tretë Xh.H.** në emër të kompensimit për ushqim gjatë ditëve te pranisë në punë, për periudhën kohore prej datës 01.01.2022 e deri më datën 20.11.2022 për 160 ditë pune t’ia kompensoj shumën prej **320.00 euro.**

- **Paditëses së katërt M.E.** në emër të kompensimit për ushqim gjatë ditëve te pranisë në punë, për periudhën kohore prej datës 01.01.2022 e deri më datën 20.11.2022 për 165 ditë pune t'ia kompensoj shumën prej **330.00 euro**.

- **Paditëses së pestë A.B.** në emër të kompensimit për ushqim gjatë ditëve te pranisë në punë, për periudhën kohore prej datës 01.01.2022 e deri më datën 20.11.2022 për 94 ditë pune t'ia kompensoj shumën prej **188.00 euro**.

Në shumën e përgjithshme prej **1,484.00 (një mijë e katërqind e tetëdhjetë e katër) euro**, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 09.02.2023, e deri në përmbushjen definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

IV. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë për paditëses A.B. mbi shumën e aprovuar e deri në lartësi prej 10.00 euro, **refuzohet si e pa bazuar**.

V. DETYROHET e paditura që paditësve t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej **342.00 (treqind e katërdhjetë e dy) euro**, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit L.Sh., I.R., Xh.H., M.E., A.B. përmes të autorizuarit të tyre av. V.H. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi me datë 09 shkurt 2023, të cilën padi e kanë precizuar me parashtrësën e datës 03.11.2023, me të cilën kanë kërkuar kompensimin e ushqimit gjatë ditëve të pranisë në punë për periudhën kohore prej datës 01.01.2022 deri me datën 20.11.2022, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me vlerë të kontestit 1,494.00 euro.

Në referatin e padisë i autorizuari i paditësve ka theksuar se paditësit janë në marrëdhënie pune në Gjimnazin "Gjon Buzuku" në Prizren dhe nuk iu janë paguar shujtat ditore në lartësi prej 2 (dy) euro në ditë, edhe përkundër se kanë bërë kërkesë zyrtare pranë DKA-së, bazuar në nenin 35 par.7 i Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe datës 22.01.2021. Më tej ka theksuar se në bazë të vërtetimeve të ditëve të punës të lëshuara nga shkolla, paditësit për periudhën 01.01.2022 deri 20.11.2022 kanë punuar këto ditë pune, L.Sh. 162 ditë pune, I.R. 161 ditë pune, Xh.H. 160 ditë pune, M.E. 165 ditë pune, A.B. 94 ditë pune, gjykatës i ka propozuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadija e paditësve. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe të njëjtat i ka specifikuar dhe atë 312 euro për përpilimin e padisë, 30 euro për taksë gjyqësore.

E paditura në përgjigjen në padi e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve. Ka theksuar se pretendimet e paditësve se i takon kompensimi deri më 31.12.2022, janë të pa bazuara për arsye se në mendimin juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.214/2023, e

datës 05.10.2023, rastet e të punësuarve që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit, duhet trajtuar deri me datë 21.11.2022, kur kjo kontratë është shkëputur nga njëra prej palëve kontraktuese. Në bazë të njoftimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nr.01B/488 të datës 21.11.2022 për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2022 padia dhe kërkesëpadia e paditësve është e pabazuar. Më tej ka theksuar se paditësit nuk kanë ofruar prova që janë anëtarë të sindikatës dhe i kanë kaluar procedurat administrative sepse nuk i kanë vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës dhe nuk i kanë shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative, po ashtu me këto veprime i shkaktojnë Komunës së Prizrenit shpenzime të mëdha, sepse e obligojnë që t'ia paguajë edhe shpenzimet e procedurës gjyqësore. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditësit nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Po ashtu thekson se në mungesë të alokimit të mjeteve nga Ministria e Arsimit, e paditura nuk mund të veproj në kundërshtim me planifikimin buxhetor. Po ashtu ka theksuar se pretendimet e paditësve janë në kundërshtim me nenin 90 para.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës nr.03/L-212 sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, dhe në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënës dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate, andaj nga të gjitha të cekurat ka kërkuar që gjykata të nxjerr aktgjykim dhe të refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune te e paditura, respektivisht në Gjimnazin “Gjon Buzuku” në Prizren, e cila bie në kompetencë të paditurës.

Gjykata përmes vërtetimit me numër të protokollit 171/45 të datës 12.01.2023 të lëshuar nga ana e të paditurës, ka vërtetuar faktin se paditësi L.Sh. në Gjimnazin “Gjon Buzuku” në Prizren, në vitin 2022 ka qenë prezent në punë 162 ditë pune.

Nga vërtetimi me numër të protokollit 1968 të datës 30.10.2023, të lëshuar nga ana e të paditurës, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi L.Sh. në Gjimnazin “Gjon Buzuku” në Prizren, nga data 01.01.2022 e deri më 20.11.2022 ka punuar 162 ditë pune.

Nga vërtetimi me numër të protokollit 171/39 të datës 12.01.2023, të lëshuar nga ana e të paditurës, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi I.R. në Gjimnazin “Gjon Buzuku” në Prizren, në vitin 2022 ka qenë prezent në punë 161 ditë pune.

Nga vërtetimi me numër të protokollit 1968 të datës 30.10.2023, të lëshuar nga ana e të paditurës, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi I.R. në Gjinnazin “Gjon Buzuku” në Prizren, nga data 01.01.2022 e deri më 20.11.2022 ka punuar 161 ditë pune.

Nga vërtetimi me numër të protokollit 171/93 të datës 12.01.2023, të lëshuar nga ana e të paditurës, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi Xh.H. në Gjinnazin “Gjon Buzuku” në Prizren, në vitin 2022 ka qenë prezent në punë 160 ditë pune.

Nga vërtetimi me numër të protokollit 1968 të datës 30.10.2023 të lëshuar nga ana e të paditurës, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi Xh.H. në Gjinnazin “Gjon Buzuku” në Prizren, nga data 01.01.2022 e deri më 20.11.2022 ka punuar 160 ditë pune.

Nga vërtetimi me numër të protokollit 171/55 të datës 12.01.2023, të lëshuar nga ana e të paditurës, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja M.E. në Gjinnazin “Gjon Buzuku” në Prizren, në vitin 2022 ka qenë prezent në punë 165 ditë pune.

Nga vërtetimi me numër të protokollit 1968 të datës 30.10.2023, të lëshuar nga ana e të paditurës, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja M.E. në Gjinnazin “Gjon Buzuku” në Prizren, nga data 01.01.2022 e deri më 20.11.2022 ka punuar 165 ditë pune.

Nga vërtetimi me numër të protokollit 171/9 të datës 12.01.2023, të lëshuar nga ana e të paditurës, ka vërtetuar faktin se paditësja A.B. në Gjinnazin “Gjon Buzuku” në Prizren, në vitin 2022 ka qenë prezent në punë 94 ditë pune.

Nga vërtetimi me numër të protokollit 1968 të datës 30.10.2023, të lëshuar nga ana e të paditurës, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja A.B. në Gjinnazin “Gjon Buzuku” në Prizren, nga data 01.01.2022 e deri më 20.11.2022 ka punuar 94 ditë pune.

Nga kontrata e punës për mësimdhënës me numër të protokollit 764 të datës 22.03.2017, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi L.Sh. ka krijuar marrëdhënie pune me të paditurën në Gjinnazin “Gjon Buzuku”, në Prizren, në vendin e punës mësimdhënës i T.I.K.

Nga kontrata e punës për mësimdhënës me numër të protokollit 11 të datës 31.10.2022, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi I.R. ka krijuar marrëdhënie pune me të paditurën në Gjinnazin “Gjon Buzuku”, në Prizren, në vendin e punës mësimdhënës i Gjuhës Boshnjake.

Nga kontrata e punës për mësimdhënës me numër të protokollit 175 të datës 15.09.2016, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi Xh.H. ka krijuar marrëdhënie pune me të paditurën në Gjinnazin “Gjon Buzuku”, në Prizren, në vendin e punës mësimdhënës I Gjeografisë.

Nga kontrata e punës për mësimdhënës me numër të protokollit 1177 të datës 15.10.2015, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja M.E. ka krijuar marrëdhënie pune me të paditurën në Gjinnazin “Gjon Buzuku”, në Prizren, në vendin e punës mësimdhënës e Gjuhës Shqipe.

Nga kontrata e punës për mësimdhënës me numër të protokollit 9 të datës 31.10.2022, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja A.B. ka krijuar marrëdhënie pune me të paditurën në Gjimnazin “Gjon Buzuku”, në Prizren, në vendin e punës mësimdhënëse e Edukatës Muzikore.

Nga leximi i kërkesës me numër 152-3 të dates 30.01.2023, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësit L.Sh., I.R., Xh.H., M.E., A.B. dhe të tjerë, i janë drejtuar Komunës së Prizrenit-Drejtorisë Komunale të Arsimit për kompensimin e shujtës ditore.

Nga përgjigja me numër 166/23 i datës 31.01.2023, gjykata ka vërtetuar faktin se Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, ka refuzuar kërkesën e parashtruar nga paditësit dhe të tjerët për kompensimin e shujtave ditore me arsyetimin se Kontrata Kolektive nuk ka gjetur zbatueshmëri në Ministrinë e Financave, përkatësisht nuk ka vijë buxhetore për kërkesën në fjalë.

Vërtetimet dhe kontratat e lartcekura, Gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*. Andaj meqë këto dokumente janë lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e të cilat edhe si të tilla janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, ashtu që vërtetimet e lëshuara nga ana e Gjimnazit “Gjon Buzuku”, në Prizren, si prova me të cilën vërtetohet fakti lidhur me ditët e prezencës në punë të paditësve, gjykata ia fali besimin e plotë, e nga e cila vërtetoi faktin se për periudhën 01.01.2022 deri 20.11.2022, L.Sh. 162 ditë, I.R. 161 ditë, Xh.H. 160 ditë, M.E. 165 ditë dhe A.B. 94 ditë, kanë qenë prezentë në vendin punës.

Me Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 22.01.2021, e më saktësisht në dispozitën 35 paragrafi 7, të KKAK-së është paraparë se *“Të punësuarve (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese, të të punësuarve për ushqim”*.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësve si mësimdhënës t’ia paguaj kompensimin për ushqimin gjatë punës, konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e në kuptim të Nenit 55 par.1 dhe 2 të Ligjit të Punës. Rrjedhimisht ditët e punës për paditësit, të vërtetuara nga vet punëdhënësi, për L.Sh. 162 ditë, I.R. 161 ditë, Xh.H. 160 ditë, M.E. 165 ditë dhe A.B. 94 ditë prezent në punë, gjykata i ka shumëzuar me shumën prej 2 euro të parapara si në nenin 35 paragrafi 7 të KKAK-së, duke ia njohur shumën e gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Andaj, bazuar në dispozitat e Nenit 398 të LPK-së, Gjykata ka vendosur si në dispozitivin nën II dhe III të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësve është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohen nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese të kërkesëpadisë së paditëses si në pikën I dhe IV të këtij aktgjykimi, gjykata, e refuzoi kërkesëpadinë e paditëses A.B. mbi shumën e aprovuar e deri në lartësi prej 10.00 euro, pasi që 94 ditë kur shumëzohen me 2 euro del shuma prej 188.00 euro e jo 198.00 euro siç ka kërkuar paditësja në padi.

Gjykata me rastin e vendosjes për refuzim të pjesëshëm të kërkesëpadisë së paditëses Arbnore Beqaj jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia.”*

Kurse sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigje në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës nuk është rrethanë e natyrës juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë me datë 09.02.2023, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 463 të LPK-së lidhur me Rregulloren për Tarifat e Avokatëve e datës 18 mars 2017, lartësia e shpenzimeve i referohet 312.00 euro për përpilimin e padisë, si dhe për taksën gjyqësore shumën prej 30.00 euro, gjithsej shumën prej 342.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 143, 398 dhe 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL

2023:036098, 03.05.2024

B.profesional
Ali Kosova

Gjyqtari
Agron Karatash

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimin të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.